



**DualAFS – Kurrikula Duale -
Studime të Integruara me Praktikën në Bujqësi dhe
Siguri Ushqimore.**

| | |
|--------------------|---|
| Programi: | Erasmus + |
| Key Action: | Cooperation for innovation and the exchange of good practices |
| Action: | Capacity Building in Higher Education (CBHE) |
| Duration: | 15.01.2021 - 14.01.2024 |

Buletini Elektronik, Nr. 7, Janar 2024

Konferenca përmbyllëse në Tiranë, 15 Nëntor 2023
"Arsimi i lartë Dual – një model premtues për përmirësimin e e formimit praktik dhe rritjen e shkallës së punësimit të studentëve në shkencat bujqësore dhe të ushqimit".

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), në bashkëpunim me Universitetin e Shkencave të Aplikuara Nürtingen – Geißlingen (NGU), Gjermani, Universitetin e Shkencave të Aplikuara Savonia (Savonia UAS), Finlandë, Universitetin e Korcës (UNIKO), Universitetin e Prishtinës (UP) dhe Universitetin e Mitrovicës (UMIB), Kosovë, si dhe me partnerët e tregut të punës (Work Life Partners) të lidhur me bujqësinë, blegtorinë dhe sigurinë ushqimore, organizuan konferencën përmbyllëse të titulluar:

"Arsimi i lartë Dual – një model premtues për përmirësimin e e formimit praktik dhe rritjen e shkallës së punësimit të studentëve në shkencat bujqësore dhe të ushqimit".

Qëllimi i kësaj konference është të diskutojë, edhe në bazë të rezultateve të këtij projekti Erasmus, mbi mundësinë e aplikimit të modelit të studimeve të dyfishta universitare (Dual ose të integruara me praktikën) në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, mbi rëndësinë e bashkëpunimit të universitetit me partnerët e tregut të punës si bashkëkontributorë veçanërisht në aftësimin praktik të studentëve, si dhe mbi zhvillimin e kapaciteteve të universitetit për të mësuarit gjatë gjithë jetës (Life Long Learning - LLL), transferimin e njohurive dhe teknologjisë në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.

Co-funded by the
European Programme
of the European Union



ERASMUS+ project 619178-EPP-1-2020-1-DE-EPPKA2-CBHE-JP
Dual Curricula – Study and Work Practice in Agriculture and Food Safety

FINAL CONFERENCE:

*"Dual university education - a promising model for improving
practical training and employment success of students in
agricultural and food sciences".*

Agricultural University Tirana (AUT), November 15, 2023
Conference Room "Luce Agraja", Building of Faculty of Agribusiness



Programi i konferencës përfshin tre sesione të titulluara:

1. Përshtatja e programeve të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe të zhvillimit të sektorit agroushqimor në Shqipëri dhe Kosovë – një nga sfidat më të mëdha për universitetet dhe fakultetet në fushën e shkencave bujqësore dhe të ushqimit.
2. Projekti DualAFS si një kontribut në aplikimin, për herë të parë, të studimeve universitare Duale në shkencat bujqësore dhe të ushqimit në Shqipëri dhe Kosovë.
3. Bashkëpunimi ndërmjet universitetit dhe partnerëve të praktikës si parakushti më i rëndësishëm për aplikimin e studimeve universitare Duale.



Në konferencë morën pjesë mbi 100 pjesëmarrës: përfaqësues të Delegacionit të BE



në Tiranë, përfaqësues të ministrive dhe agjencive publike qendrore të fushës së bujqësisë, pedagogë të universiteteve partnere të projektit dhe studentë të programeve të drejtimit të zooteknisë dhe bujqësisë të UBT, përfaqësues të sektorit privat, kryesisht të fushës

së blegtorisë, partnerë të tregut të punës, përfaqësues të organizimeve të fermerëve dhe biznesit agroushqimor, fermerë dhe sipërmarrës të këtij sektori, drejtues të shkollave profesionale, drejtues të projekteve të huaja dhe OJQ, si dhe ekspertë që punojnë në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe sigurisë ushqimore.



Zv.Rektorja e UBT Prof. Dr. Erinda Lika, hapi sesionin e fjalimeve të mirëseardhjes në këtë konferencë.

Prof. Dr. Heinrich Schuele, Drejtues i projektit dhe Dekan për mësimin në



universitetin partner gjerman, NGU, Germany, u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve në konferencë dhe bëri një përmbledhje të shkurtër mbi nismën për të formuar konsorciumin e universiteteve dhe për atë aplikuar për këtë projekt, mbi arsimin e lartë Dual në bujqësi, ku NGU, si një nga pionierët në aplikimin e këtij modeli në shkencat bujqësore, ka një përvojë të pasur; mbi përvojën shumë të mirë të bashkëpunimit ndërmjet partnerëve të konsorciumit për realizimin e këtij projekti; mbi rezultatet interesante të arritura në këtë projekt dhe rëndësinë e tyre për përmirësimin e programeve të studimit në Shqipëri dhe Kosovë në

fushën e shkencave bujqësore dhe të ushqimit. Ai, gjithashtu, nënvizoi se kjo përvojë mjaft pozitive, e fituar në këtë projekt, mund të përdoret në mënyrë efektive për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet partnerëve të konsorciumit në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor.

Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rektori i UBT-së, si universiteti organizator dhe



mikpritës i kësaj konference u uroi të pranishmëve mirëseardhjen. Në fjalën e tij, Rektori Sallaku vuri në dukje se përshtatja e programeve të studimit të UBT me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe ushqimit në Shqipëri është një nga sfidat më të mëdha për UBT-në. Ai theksoi se rezultatet e këtij projekti mund të jenë një bazë e mirë, jo vetëm për ne si partnerë të projektit, por edhe për institucionet e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri dhe Kosovë, në përballjen me këto sfida të vështira, kur bëhet fjalë për përafrimin e programeve të studimeve terciare me nevojat e shoqërisë, zhvillimit

ekonomik dhe të tregut të punës në vendet tona. Në fund, ai falënderoi programin Erasmus të BE-së dhe të gjithë partnerët në këtë projekt. Ai e mbylli fjalën e tij me besim të plotë se kjo përvojë shumë e mirë e bashkëpunimit, e krijuar në kuadër të konsorciumit të këtij projekti (DualAFS), do të shërbej si një bazë e mirë për projekte të reja, si në fushën akademike ashtu edhe në atë të kërkimit dhe zhvillimit.

Z. Andrea Ferrero – Drejtues i Seksionit për Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik Social, pranë



Delegacionit të BE në Shqipëri - u ndal, në fjalën e tij, në mundësitë e mëdha që ofrojnë programet e BE, Erasmus dhe Horizon, për zhvillimin e universiteteve shqiptare, sidomos në sektorët e rëndësishëm të bujqësisë dhe ushqimit. Ai theksoi mundësitë e mëdha që ofrojnë këto programe për studentët dhe pedagogët e rinj të universiteteve shqiptare. Ai përfundoi fjalën duke ftuar universitetet partnere në këtë

projekt, që të vazhdojnë bashkëpunimin dhe të përfitojnë nga mundësitë që ofrojnë programet e BE-së.

Në seancën plenare me titull "**Projekti DualAFS - si kontribut në aplikimin e**



studimeve Duale në shkencat e bujqësisë dhe ushqimit në Shqipëri dhe Kosovë - një bashkëpunim i suksesshëm dhe premtues", moderuar nga Prof. Dr. Heinrich Schüle, Drejtues i Projektit (NGU), dhe MSc Petri Kainulainen - Dekan i Savonia UAS, Kampusi Iisalmi, u mbajtën prezantimet e mëposhtme.

Në fjalën e tij, **MSc. Petri Kainulainen**, u ndal në përvojën e Universitetit të Shkencave të Aplikuara Savonia në përshtatjen e kurrikulave dhe programeve të studimit në bujqësi dhe mjedis me kërkesat e tregut të punës dhe rolin e WLP në këtë proces.

Prof. Merita Shala - Rektorja e Universitetit të Mitrovicës (UMIB), vlerësoi rolin e



madh të projektit DualAFS në mbështetjen e procesit reformues të programeve të studimit në UMIB dhe gatishmërinë e institucionit që ajo drejton për të vazhduar këtë bashkëpunim të suksesshëm të arritur në këtë konsorcium edhe për projekte të tjera.

Dr. Festim Shytaj, drejtues i Seksionit të Zooteknisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), nënvizoi në fjalën e tij nevojën e madhe të sektorit të blegtorisë për profesionistë të mirëtrajnuar në fushën e zooteknisë, veçanërisht tani kur vendi ynë duhet të përshtatë dhe zbatojë standardet e BE-së në blegtori, pasi Shqipëria ka nisur tashmë negociatat me BE-në. Në fund të seancës plenare, të pranishmit diskutuan për temën e këtij sesioni.



Në sesionin e parë me temë "Implementimi I programeve Duale në fushën e bujqësisë dhe ushqimit – sfida dhe e ardhmja", moderuar nga **Zv.rektori i UBT, Prof. Dr. Ilir Kapaj, dhe **Prof. Dr. Anila Hoda (UBT)**, u prezantuan objektivat dhe rezultatet kryesore të projektit DualAFS në universitetet partnere në këtë projekt.**



Prof. Dr. Jürgen BRAUN (NGU) foli për përvojën e NGU për “**Integrimin e praktikës**



në kurrikulat e programeve Master”, përmes një shembulli të një programi Master në fushën e ekonomisë dhe mjedisit. Kjo përvojë mund të shërbejë si një referencë për përshtatjen e programeve Master të UBT në bujqësi, mjedis dhe ekonomi agrare.



Prof. Dr. Myqerem Tafaj (UBT) në referatën e tij “**Implementimi i programit Bachelor Dual ‘Zootekni & Siguria e Produkteve Blegtorale (ZSPB)’ në UBT –sfida dhe e adhmja”**, prezantoi rezultatet kryesore të arritura në zbatimin e këtij programi Bachelor të riorganizuar sipas modelit Dual në UBT, si dhe disa ide mbi mundësinë të aplikimit të modelit Dual në studimet universitare në vendin tonë, veçanërisht në fushën e bujqësisë, mjedisit dhe ushqimit. Në këtë kuadër, u diskutua edhe nevoja për përmirësime të kuadrit ligjor për aplikimin e këtij modeli, veçanërisht në lidhje me realizimin e praktikave Duale profesionale në sipërmarrje, me bashkëpunimin dhe njohjen e kontributit të partnerëve të

WLP-së, si dhe me aspektet që rregullojnë raportin midis teorisë dhe praktikës në standardet e programeve të arsimit të lartë.

Dr. Dorian Marku (UNIKO) në referatin "Implementimi i programit Bachelor Dual në Manaxhimin Bujqësor në UNIKO- sfida dhe perspektiva",



prezantoi rezultatet kryesore të implentimit të programit Bachelor Dual në AM, duke u përqëndruar në realizimin e praktikës Duale, rregullimin e saj dhe modelin e bashkëpunimit të universitetit me bizneset, si partnerë të tregut të punës.



Prof. Dr. Muhamet Kamberi (UP) në temën e tij "**Përmirësimi i formimit praktik në kurrikulat e zooteknisë në UP - sfidat dhe e ardhmja**", foli mbi përmirësimet e bëra në programin të zooteknisë të UP si dhe sfidat për të ardhmen e zbatimin e tij në Kosovë.



Prof. Dr. Valdet Gjinovci (UMIB) në prezantimin e tij "**Përmirësimi i formimit praktik në programet e shkencave të ushqimit në UMIB - sfidat dhe e ardhmja**", i cili, gjithashtu, nënvizoi kërkesat e tregut të punës në Kosovë për programet e studimit që afron UMIB në këtë fushë.





MSc Florian Plaku (UBT) prezantoi përvojën e fituar si një pedagog i ri në metodat inovative të mësimdhënies në Savonia UAS-Finlandë dhe mendimet e tij për transferimin e tyre në mësimdhënie në universitetin e tij.

Në fund të këtij sesi u zhvillua një diskutim përfundimtar.

Në sesionin e 2-të me titull **“Bashkëpunimi midis universitetit dhe partnerëve të praktikës si parakushti më i rëndësishëm për aplikimin e arsimit të lartë Dual”**, moderuar nga **Prof. Dr. Ilir Kristo**, dekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit të UBT dhe **Prof. Myqerem Tafaj (UBT)**, referuan përfaqësues të sektorit privat si partnerë në zbatimin e modelit Dual në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe sigurisë ushqimore.



Dipl. Ing. agr. Bianca Duro, Drejtore e Austria Praemix Albania dhe e Austrian



Institute of Excellence, mbajti prezantimin me titull: **“Industria e ushqimeve për blegtorinë ka nevojë për specialistë të trajnuar mirë - si mund të kontribuojë sektori privat në këtë në bashkëpunim me universitetin?”**. Nisur nga eksperiencia e saj 20 vjeçare si sipërmarrëse në industri dhe kompaninë e saj që përfaqëson në Shqipëri, ajo parashtrori pritshmëritë e sektorit të blegtorisë, përsa i përket kompetencave dhe aftësive që duhet të kenë të

sapodiplomuarit në programet e studimit në fushën e zooteknisë dhe sigurisë së produkteve shtazore.

Dipl. Ing. Alban Zusi, Kryetar i Shoqatës së Prodhuesve dhe Eksportues, foli për



nevojën e madhe të industrisë ushqimore për specialistë të mirëtrajnuar dhe mundësinë e bashkëpunimit midis universitetit dhe kompanive, jo vetëm për praktikën profesionale të studentëve, por edhe për kërkimin e aplikuar, inovacionin dhe shërbimet, bazuar në përvojën e tij shumëvjeçare si një sipërmarrës, ekspert dhe vendimmarrës në sektorin bujqësor dhe ushqimor.

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Ekonomist Agim Rrapaj, i cili ka një eksperiencë shumëvjeçare në përfaqësimin e fermerëve të Shqipërisë, vuri



në dukje, në fjalën e tij, nevojën e gjithë sektorit të bujqësisë për specialistë të mirëtrajnuar dhe theksoi interesin e madh të kësaj shoqate për një bashkëpunim më të fortë me UBT.

Të tre folësit nga sektori privat si dhe pjesëmarrësit e tjerë të këtij sesioni, diskutuan dhe konsideruan, në diskutimin përfundimtar të këtij sesioni, kontributin e sektorit privat të bujqësisë, blegtorisë dhe industrisë ushqimore për aftësimin praktik të studentëve të

bujqësisë, pothuajse si një detyrim minimal i sektorit privat, pasi kjo do të mundësonte rritjen e nivelit të përgatitjes së profesionistëve të rinj, të cilët do të punojnë, për 4-5 dekadat që vijnë, në këta sektorë kyc të ekonomisë shqiptare, si bujqësia, blegtoria dhe ushqimi.

Një objektiv i rëndësishëm i këtij projekti për UBT është **institucionalizimi i bashkëpunimit midis UBT dhe sektorit privat (ferma/kompani) në blegtori, jo**



vetëm për implementimin e praktikës profesionale Duale të studentëve të programit Bachelor Dual në "Zootekni & Siguria e Produkteve Blegtorale –ZSPB", por edhe për komponentin tjetër, atij të "Të mësuar gjithë



Jetës (LLL)" në forma të ndryshme, si trajnimet, konsulenca dhe shërbimet e UBT për partnerët e sektorit privat, d.m.th. fermat dhe bizneset e sektorit të blegtorisë.

Grupi i pedagogëve të UBT, antarë të Komitetit Drejtues të Projektit DualAFS, ka



arritur të zhvilloj dhe konkludoj me sukses 18 Marrëveshje të bashkëpunimit me ferma dhe kompani të industrisë së ushqimeve për blegtorinë. Përfaqësuesit e këtyre fermave dhe kompanive nënshkruan marrëveshjet në fund të sesionit të dytë të konferencës me Rektorin i UBT-së, Prof. Sallaku. Pas nënshkrimit, këto

marrëveshje do të hyjnë në fuqi dhe do të filloj zbatimin e tyre. Duke qenë se këtë vit akademik (2023/24), grupi i parë i studentëve të programit dual Bachelor në ZSPB do të zhvillojë Praktikë Duale, ata do të kenë mundësinë të kryejnë praktikën e tyre në ferma, biznese dhe kompani që tashmë kanë nënshkruar marrëveshje me UBT.



Konferenca përfundoi me një diskutim të pjesëmarrësve mbi bashkëpunimin e ardhshëm midis partnerëve të DualAFS.

Prof. Dr. Heinrich Schüle (NGU) dhe Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rektori i UBT, përmbledhën shkurtimisht rezultatet e kësaj konference përmbyllëse të projektit

DualAFS dhe falënderuan të gjithë pjesëmarrësit për pjesëmarrjen e tyre aktive në diskutime në sesionet e ndryshme të konferencës. Në fund, të dy folësit theksuan përvojat shumë të mira në bashkëpunimin mes partnerëve të konsorciumit DualAFS, si bazë e shkëlqyer për vazhdimin e bashkëpunimit mes partnerëve në projekte të reja në fushën e mësimdhënies dhe atë të kërkimit shkencor.

**Seminari " Zhvillime në të ushqyerit, mbarështimin dhe mirëqenien e kafshëve të fermës",
UBT, Departamenti i Shkencave Zooteknike, 14 Nëntor 2023**

Përveç objektivit kryesor të projektit DualAFS, aplikimi i një programi Bachelor Dual



„Zootekni & Siguria e Produkteve Blegtorale (ZSPB)“ në UBT dhe në Menaxhim Bujqësor (AM) në UNIKO, një tjetër komponent i rëndësishëm i këtij Projekti ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të Departamentit të Shkencave Zootekni (DSHZ) dhe Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (FBM) të

UBT për të ofruar këshillim dhe shërbime për fermat blegtorale dhe bizneset, të cilët do të kontribuojnë në realizimin e praktikës Duale të studentëve në ferma/biznese.



Me qëllim njohjen e veterinerëve, ekstensionistëve të blegtorisë dhe fermerëve me disa nga zhvillimet më të fundit në të ushqyerit, mbarështrimin dhe mirëqenien e

kafshëve të fermës, UBT, në kuadër të projektit Erasmus, organizoi seminarin njëditor "Zhvillimet në të ushqyerit, mbarështrimin dhe mirëqenien e kafshëve të fermës", në



bashkëpunim me NGU dhe partnerët lokalë, projektin GIZ, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) dhe Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar Shqiptar (UPMVSH).

Ky seminar ishte i orientuar jo vetëm për studentët e programeve të zooteknisë, por edhe ekstensionistët e blegtorisë si dhe veterinerët që këshillojnë fermat blegtorale ose punojnë në sektorin publik si veteriner shërbimi. Seminari u zhvilluan më 14



Nëntor 2023, në UBT. Rreth 120 specialistë zooveterinerë të praktikës dhe studentë morën pjesë në këtë seminar. Lektorët në seminar ishin një grup profesorësh dhe kërkuesish të NGU, të cilët zhvilluan një

vizitë studimore në UBT në kuadër projektit DualAFS.

Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve në dhe nënvizoi rëndësinë që UBT jep funksionit të transferimit të njohurive dhe LLL për praktikën. Gjithashtu, Prorektorja e UP, **Prof.asoc.dr.Pranvera Breznica-Selmani**,



Manaxherja e projektit **MSc Sara Pfaff (NGU)**, **Dr. Ardita Hoxha** nga **Savonia UAS /Finlandë**,



Dekani i Fakultetit të Bujqësisë të UNIKO, Prof. Gjergj Mero, Drejtori i përgjithshëm i AKVMB, DMV Roland Mecaj, dhe



Presidenti i Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar Shqiptar (UPMVSH), DMV Ervin Resuli përshëndetën pjesëmarrësit në seminar.




Në sesionin I, Prof. Dr. Dirk Winter (NGU) mbajti leksionin “*Optimizimi i të ushqyerit të ripërtpësve përmes vlerësimit të ushqimeve me anë të NIRS.*”, me bashkëautor, Prof. Stephan Schneider (NGU). Pjesa e dytë e leksionit titullohej “*Industria e kuajve në Gjermani*”.



MSc Heiko Esslinger mbajti leksionin e përgatitur me Prof. Dr. Maren Bernau



“*Zhvillime të sotme në mbarështimin dhe mirëqenien e dhive*”.



Në sesionin II, MSc Ines Maurmann mbajti prezantimin “*Aplikime të teknikave lineare në vlerësimin e gjendjes së mirëqenies së kafshëve: shembull nga dhitë në laktacion*”.



MSc Sara Goth prezantoi “*Aplikime të termografisë në vlerësimin e mirëqenies së*



kafshëve: shembull nga dhitë në laktacion”.

Dr Xhafa (GIZ, Albania) prezantoi temën “*Aktivitete të projektit SRD II në zinxhirin e prodhimit dhe përpunimit të qumështit*”.



Në fund të seminarit, pjesëmarrësit ndoqën në laboratorin e Cilësisë së Ushqimeve



për blegtorinë të DSHZ të UBT një demonstrim të vlerësimit të ushqimeve me anë të metodës NIRS duke përdorur pajisjen Unity Scientific Spectrostar 2600 XT-R, të siguruar në kuadër të projektit DualAFS. Ky demonstrim u drejtua nga **Prof Dr Enkelejda Sallaku (UBT)** dhe **Prof. Dr. Muhamet Kamberi (UP)**.

Seminari përfundoi me një sesion pyetjesh dhe diskutimesh.



Pjesëmarrësit e konsideruan seminarin dhe përmbajtjen e prezantimeve në të si



shumë relevante për trajnimin profesional në fushën e zooteknisë. Ata rekomanduan që seminare, me tematikë të tillë, të organizohen edhe për specie të tjera të kafshëve, si derrat,

shpendët dhe kafshët e shoqërimet.

Pjesëmarrësit në këtë seminar përfituan Kredite trajnimi për zhvillim profesional, të dhëna nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar Shqiptar.



Përfundimi i Projektit, fundi i janarit 2024

Projekti DualAFS do të përfundojë më 14 janar 2024. Konsorciumi i projektit do të mbajë punën e zhvilluar në DualAFS dhe do të mbajë rezultatet e arritura. Edhe pse ky është E-Newsletter i fundit, faqja e internetit e DualAFS do të mirëmbahet dhe do të jetë funksionale.

Me këtë rast, i gjithë konsorciumi i projektit dëshiron t'ju falënderojë për interesimin tuaj për punën, zhvillimet dhe rezultatet e DualAFS.

Project partners and contacts

| | | |
|--|----------------------------|--|
| Nuertingen-Geislingen University, Germany | Prof. Dr. Heinrich Schuele | heinrich.schuele@hfwu.de |
| Savonia University of Applied Sciences, Finland | Dr. Ardita Jahja-Hoxha | Ardita.hoxha-jahja@savvonia.fi |
| Agricultural University of Tirana, Albania | Prof. Dr. Anila Hoda | ahoda@ubt.edu.al |
| University "Fan Noli" Korce, Albania | Prof. Dr. Gjergji Mero | gmero@unkorce.edu.al |
| University of Prishtina, Kosovo | Prof. Dr. Skender Muji | skender.muji@uni-pr.edu |
| University "Isa Boletini" of Mitrovica, Kosovo | Dr. Arber Hyseni | arber.hyseni@umib.net |
| Livestock and Rural Development Centre, Albania | Prof. Dr. Gori Stefi | gori.stefi@gmail.com |
| Kosovo Food and Veterinary Agency, Kosovo | Kujtim Uka | kujtim.uka@rks-gov.net |
| Kosovo Association of Milk Producers, Kosovo | Gente Kadriu | kadriugenta@gmail.com |
| Agricultural Technology Transfer Center, Korca, Albania | Eleni Elefteri | eleni.elefteriu@yahoo.com |

Quality Assurance Agency in Higher Education, Albania

Dr. Xhiliola Bixheku

xhiliola.bixheku@ascal.al

Association AGRINET, Albania

Tomi Pikuli

tomi_pikuli@yahoo.com

Nucleus Albania

Valbona Paluka

valbona.paluka@nucleus.al

Text & Layout

Myqerem Tafaj, and Anila Hoda
Agricultural University of Tirana

Sara Pfaff, Nuertingen-Geislingen University

© 2020-2024, DualAFS.

All rights reserved.

Pictures

© University "Isa Boletini" of Mitrovica, Kosovo

© University "Hasan Prishtina" of Prishtina, Kosovo

© Agricultural University of Tirana, Albania

© Savonia University, Finland